



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

|                         |  |
|-------------------------|--|
| Datë/a:                 | 15.07.2021   |
| Referenc-ë:             | 07-353/04-135511/21  |
| Për/ Za/ To:            | “Federata e Çiklizmit të Kosovës”  |
| Përmes/Preko/Through:   | Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit  |
| Nga/ Od/ From:          | Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike<br>Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit |
| Tema/ Subjekat/Subject: | <b>Pëlqim</b>  |

Drejtorija e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit ka pranuar kërkesën me nr protokoll 07-353/04-135511/21 nga “Federata e Çiklizmit të Kosovës”, lidhur me shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Nëna Terezë” para Teatrit Kombëtarë ku do të vendoset caku me dimensione 6x1m.

Me datë 16 Korrik 2021 do të vendoset një binë me dimensione 4x3m dhe disa ulëse, gjithashtu kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike pran përmendores “Ibrahim Rugova” në kohëzgjatje prej orës 10:30 deri në 11:15 parkimin e veturave të konvojit të çiklizmit ku numri i tyre do të jetë 18 sosh ku përfshihen makinat e policisë, gjyqtarisë, ekipeve pjesëmarrëse, ndihmës së shpejtë dhe makinat tjera që do ta përcjellin garën gjatë gjithë kohës.

Shërbimi profesional i drejtorisë ka shqyrtuar kërkesën e juaj dhe bazuar në rëndësinë e këtij organizimi, Drejtorija jep **Pëlqimin** për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Nëna Terezë” para teatrit Kombëtar për vendosjen e binës me dimensione 4x3m dhe vendosjen e disa ulëseve për mbajtjen e aktivitetit, si dhe për parkimin e veturave në sheshin “Ibrahim Rugova”.

Nisja fillon nga sheshi “Ibrahim Rugova” duke vazhduar për Dragodan rruga “Ahmet Kaqiku” dhe do të vazhdohet për Mazgit.

Pëlqim ka karakter të përkohshëm dhe vlen me datën 16 Korrik 2021.

**Vërejtje: Parashtruesi i kërkesës për realizimin e këtij aktiviteti është i obliguar që ti përmbahet rregullave të parapara me Ligjin Rregullat e Trafikut Rrugor Nr. 05/L – 088.**

**Për mbarëvajtjen e aktivitetit të cekur më lart duhet të përkujdeset Policia e Kosovës, Ndihma e Shpejt, të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës si dhe pas përfundimit të aktivitetit të bëjë pastrimin e vendit të gjitha dëmtimet e shkaktuara duhet ti sanoj.**

**Nëse nuk konfirmohet prezenca e ekipeve të cekura më lart ky Pëlqimi nuk vlen.**

Kopje për:

- Drejtorin e Inspeksionit Komunal – Prishtinë;
- Zyrës pritëse QSHQK.